



Prishtinë, 13 prill 2017
Kodi i ZRRE: V_909_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, 1.9, 1.11, Nenit 16, paragrafi, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 45, Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6, Nenit 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Vendimi nr. V_516_2013 për TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR);
- Të dhënat e dërguara nga KEK Sh.A. më datë 4 prill 2017, në lidhje me realizimin e investimeve të lejuara për periudhën 4 vjeçare rregullative;
- Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Republikën e Kosovës të nxjerrë nga ZRRE, në seancën e mbajtur më 13 prill 2017 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN AZHURNIMET PËR INVESTIMET KAPITALE, të periudhës rregullative katër (4) vjeçare 2013-2016, për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK SH.A), që do të realizohen nga KEK SH.A. duke filluar nga data 1 maj 2017.
- II. Vlera e zhvlerësimit dhe kthimit, të përshtatur për interes, e cila rrjedhë nga ndryshimi në mes të vlerës së investimeve të lejuara nga ZRRE dhe atyre të realizuara nga KEK SH.A. për periudhës rregullative 2013-2016, është **21,534,381 €**.
- III. Kompensimi duhet të bëhet për të gjithë konsumatorët të cilët kanë mbuluar kostot e zhvlerësimit dhe kthimit, prandaj KEK SH.A. do të kthej këtë kosto përmes Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), në formë të energjisë, brenda një periudhe dy (2) vjeçare sipas diapozitivit nën pikën I të këtij vendimi.
- IV. Për vitin e parë (2017/2018) KEK Sh.A. do të furnizojë OST-në me energji elektrike, të barasvlershme me 10,767,190 € (nëse çmimi i energjisë me shumicë mund të merrej si çmim

referent i tregjeve evropiane si EEX apo HUPX i cili sillet rreth 35 €/MWh, atëherë sasia e energjisë për të kompensuar vlerën prej 10.8 mil € do të jetë 302 GWh).

- V. Për vitin e dytë relevant (2018/2019), KEK Sh.A. obligohet që të furnizojë OST-në me energji elektrike, të barasvlershme me 10,767,191 €.

ARSYETIM

- ✚ ZRRE, gjatë Shqyrtimit Periodik 4 vjeçar ka lejuar investime kapitale për periudhën rregullatve 2013-2016, të cilat do të ndikonin në përmirësimin e performancës së sistemit energjetik në përgjithësi dhe të gjenerimit në veçanti. Vlera e përgjithshme e investimeve të lejuara në KEK Sh.A. për periudhë katër (4) vjeçare ka qenë 208.4 milion €, ku përfshihen investimet në: TC Kosova A, 58.4 milion €; TC Kosova B, 44.1 milion €; dhe Mihje 105.9 €.
 - ✚ Rregullatori, më datë 4 prill 2017, ka pranuar të dhënat nga KEK në lidhje me realizimin e investimeve të lejuara për periudhën 4 vjeçare rregullative.
 - ✚ Rregullatori për azhurnimet e investimeve kapitale të KEK Sh.A. ka marrë parasysh edhe dokumente shtesë si në vijim:
 - Raportin e azhurnimeve për investimet kapitale të KEK SH.A;
 - Vlerësimin përfundimtar i ZRRE-së të MAR të KEK-ut në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar;
 - Llogaritjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar – SHTE8;
 - Vlerësimin e ndikimit në të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe rishqyrtimi tarifor – Shqyrtimi I jashtëzakonshme;
 - Llogaritjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar – SHTE9;
 - Llogaritjen e të Hyrave të Maksimale të Lejuara (MAR) dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar – SHTE10;
 - Raportin Monitorues për KEK (2013-2015);
 - Vlerësimin përfundimtar- Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Raportin Konsultativ- Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT), i publikuar me datën 28 shkurt 2017;
 - Raportin përfundimtar për të hyrat e lejuara Maksimale të OS/OT, i publikuar më datën 30 mars 2017;
- VI. Të dhënat e dërguara nga KEK dhe të vërtetuara nga ZRRE, paraqesin gjendje në aspektin e investimeve të realizuara për periudhën 4 vjeçare të rregullimit. Nga vlera e përgjithshme e lejuar e investimeve, KEK në të gjitha divizionet, ka realizuar 101.4 milion €, nëpër vite si në tabelën në vijim:


INVESTIMET NË KEK PËR PERIUDHËN SHUMËVJEÇARE								
Viti	MIHJE		TC KOSOVA A		TC KOSOVA B		Total	
	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)
2013	14.51	8.44	23.02	30.46	9.07	1.87	46.60	40.77
2014	39.95	10.44	17.71	9.81	5.50	9.19	63.16	29.45
2015	41.45	6.19	10.21	8.87	16.50	6.04	68.16	21.10
2016	9.95	5.92	7.50	2.60	13.00	1.60	30.45	10.12
Total	105.87	30.98	58.44	51.74	44.07	18.71	208.38	101.43


Tabela 1 – Investimet në KEK për periudhën katër vjeçare

- VII. ZRRE ka kryer të gjitha kalkulimet e nevojshme nga të cilat zhvlerësimi dhe kthimi, të përshtatur për interes, për periudhën rregullative 2013-2016, të pranuar nga KEK SH.A. për investimet e përcaktuara, është 21,534,381 €.
- VIII. Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IX. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- X. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të jetë efektiv nga data 1 maj 2017 dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Krenar Bujupi, u.d.kryesues


Arsim Janova, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KEK SH.A.
- KOSTT SH.A. dhe
- Arkivit të ZRRE-së